UniFin

Kursim̈-Kredi që prej 1996

RAPORT VJETOR 2017

KREDI KONSUMATORE

KREDI BIZNESI

KREDI AGRO

DEPOZITA



PËRMBAJTJE

Fjala e Kryetares së Këshillit Drejtues	3
Fjala Hyrëse e Administratores	4
Profili i Institucionit	6
Misioni, Vizioni & Vlerat	7
Strukturat Drejtuese	8
Produktet & Shërbimet	10
Përgjegjësia Sociale	11
Treguesit Financiarë	12
Shpërndarja e Portofolit	13
Sfidat & Arritjet	14
Një Imazh i ri i Institucionit	16
Ambiciet e Institucionit	18
Pasqyrat Financiare	19
Raporti i Auditit të jashtëm	21
Rrjeti i Degëve UniFin	24
Anëtarët tanë	25

FJALA E KRYETARES SË KËSHILLIT

Të ndëruar Anëtarë !

Është kënaqësi të prezantosh arritjet e UniFin në vitin 2017. Ky vit ka qënë një nga vitet më të rëndësishëm për konsolidimin e Unionit tonë. Marrja e certifikatës nga ASD e bën institucionin tonë një nga strukturat më të sigurta në tregun Shqiptar të mikrokredive. Marrja e çertifikatës ishte një proçes i gjatë dhe me shumë kërkesa i cili u realizua falë punës dhe përkushtimit të stafit të UniFin.

Sot ne jemi krenarë të paraqesim arritjet tona, të cilat nëse i krahasojmë me tre vite më parë në disa tregues janë dyfishuar. UniFin falë vizionit të tij , përkushtimit të stafit dhe anëtarëve ka arritur të dyfishojë kapitalin e tij nga 103 milion lekë në 2017 në 219,5 milion lekë. Ka rritur nivelin e aseteve me 1.4 herë dhe po kaq portofolin e depozitave.

Rritja jonë nuk ka qenë vetëm në tregues monetarë, në burime njerëzore por dhe në infrastrukturë e mbi të gjitha në imazhin tonë. Krijimi i një imazhi të ri për UniFin na bën tashmë më të dalluashëm aty ky jemi dhe thekson individualitetin tone në tregun financiar. Strategjia jonë e marketingut ka ndikuar qe edhe numri i anëtareve të pësojë rritje. Nga 14,589 anëtarë që ne kishim në vitin 2016 , në vitin 2017 ky numër arriti në 15,256 anëtarë.

Politikat tona të kreditimit kanë ruajtur si gjithmonë atë çfarë është dhe e dallueshme për ne “ vënien e anëtarit, individit në qendër të punës dhe vëmendjes tonë”. Kjo politikë e ndjekur është shprehja më e qartë e aspektit social , duke mishëruar në këtë mënyrë dhe synimin e shprehur në Vizionin Strategjik të UniFin lidhur më përgjeg-jshmërinë sociale.

Arritjet e deritanishme janë shprehja më e qartë e qëllimit tonë të përbashkët që të jemi sa më të suksesshëm e t’i shërbejmë sa më mirë komunitetit tonë të anëtarëve.

Le të vazhdojmë më tej për të konsoliduar arritjet tona!

Jolanda Trebicka
Kryetare e Këshillit Drejtues

FJALA E ADMINISTRATORES

Të nderuar anëtarë, të nderuar lexues,

Kam privilegjin , si Administratore e Shkk-së UniFin të paraqes tek ju, anëtarët tanë, raportin vjetor për fundin e vitit 31 Dhjetor 2017 . Ky raport ilustron aktivitetet, burimet dhe rezultatet e SHKK-së sonë per këtë periudhë.

Jam e kënaqur t'ju raportoj përfundimin me sukses të proçesit të konsolidimit të të gjtha shkk-ve dhe Unionit të tyre Jehona. Proçes i cili filloi në fund të vitit 2015 me konsolidimin e të gjitha shkk –ve në një të vetme dhe përfundoi më pas me shndërrimin e Unionit Jehona dhe shkk-së së saj të vetme Newcred, në SHOQERINE E KURSIM KREDITIT UNIFIN.

Momentet kulmore të këtij proçesi qenë çertifikimi i SHKK –së UniFin nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave , duke siguruar kështu për herë të parë depozitat e anëtarëve tanë deri në shumën 2,000,000 lekë si dhe marrja e liçensës së re në emrin e SHKK Unifin nga Banka e Shqiperisë.

Me kënaqësi raportoj gjithashtu një komplet treguesish të kënaqshëm që arritëm për këtë vit, me vazhdimin e rritjes së numrit të anëtarëve , depozitave dhe tepricës vjetore. Numri i anëtarëve u rrit me 667 anëtarë të cilët ju bashkuan aktivitetit të shkk-së dhe përfituan nga shërbimet e saj, depozitat e anëtarëve shënuan shifrën 791 milion nga 781.7 milion që ishin në fund të vitit 2016.

Cilësia e kredive me probleme është mbajtur nën kontroll dhe në nivele të ulta NPL në masen 5.4%. Shkk-ja është shumë mirë e kapitalizuar dhe ka një mjaftueshmeri kapitali në masën 28.4%.

Megjithëse portofoli i huasë pati rënie për shkak të periudhës së shndërrimit, Shkk-ja arriti të realizojë një shtesë në kapitalin e saj prej rreth 10 milion lekë në formën e tepricës vjetore, dhe të mbajë të pandryshuar normat e interesit të depozitave, që vazhdojnë të jenë me konkurueset në treg.

FJALA E ADMINISTRATORES

Me përfundimin e proçesit të gjatë të konsolidimit , Shkk-ja ka filluar realizimin me intensistet të zbatimit të planit të saj 3 vjeçar për zgjerim të aktivitetit nëpërmjet investimeve si në burime njerëzore ashtu dhe në infrastrukturë.

Në këtë kuadër, viti 2017, shënoi dhe rinovimin dhe marketimin më të mirë të të 15 degëve të SHKk-së UniFin , duke siguruar jo vetëm plotësimin e kushteve rregullatore për siguri të zyrave por edhe ambiente lehtësisht të aksesueshme, miqësore dhe mikëpritese për shërbimin e anëtarëve dhe kushteve të mira të punës për punonjësit tanë.

Shkk Unifin u shtua në burime njerëzore, si në degë ashtu edhe në qendër, duke e bërë numrin total të punonjësve në 38 në fund të vitit 2017.

Një nga fokusimet e rëndësishme të Shkk-së në vitin që lamë pas dhe që do të vazhdojë të jetë edhe në të ardhmen është menaxhimi i riskut të shkk-së nëpërmjet forcimit të mëtejshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të Shkk-së, në mënyrë që të sigurojmë që çdo hap dhe vendim i marrë të mbrojë asetet e anëtarëve që na janë besuar.
Ju uroj lexim të këndshëm të këtij raporti dhe punime të mbara Asamblesë Vjetore.

Elvana Sharkaj
Administratore



PROFILI I INSTITUCIONIT

Shoqëria e Kursim Kreditit UniFin ushtron aktivitetin e saj financiar në fushën e kredisë dhe depozitave që prej vitit 1996. Me një shtrirje të gjerë në territorin e Shqipërisë, UniFin numëron sot 15 degë prezente në zonat rurale si dhe ato urbane me qëllim përmbushjen e nevojave financiare të çdo individi duke ofruar kushte të favorshme dhe aksesueshmëri maksimale. Produktet kryesore të UniFin ndahen në kredi dhe depozita. Produktet e Kredisë përfshijnë Kredinë Konsumatore, Kredinë Agro si dhe Kredinë drejtuar Biznesit. Produkti i Depozitës ofron kursime me dhe pa afat me interesa tejet konkuruese në tregun vendas.

Gjithashtu SHKK UniFin ka në fokus krijimin e aksesit në financa të asaj pjese të popullsisë që janë të pa shërbyer nga sistemi Bankar dhe që janë ne linjën e varferisë. Qëllim tjetër i UniFin është edhe fuqizimi i gruas dhe jo rastësisht rreth 50% e antarëve kredimarrës janë të gjinisë femër.

UniFin është e liçensuar nga Banka e Shqipërisë e cila mbikëqyr në mënyrë të vazhdueshme aktivitetin financiar të Instucionit si dhe sigurohet nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD), duke ofruar kësisoj siguri dhe transparencë maksimale për anëtarët.

UniFin është një Institucion jofitimprurës, i cili ndryshe nga shumica e Institucioneve të tjera financiare zotërohet në tërësi nga anëtarët e saj. Fitimet e gjeneruara nga produktet dhe shërbimet riinvestohen në Institucion duke siguruar kushte sa më të favorshme për anëtarët. Duke u mbështetur në vlera dhe parime të tilla si solidariteti, transparenca dhe Integriteti, SHKK UniFin është një nga partnerët më të besueshëm në fushën e mikrofinancës në vend.

- SHKK-të janë jo fitimprurëse.
- I gjithë fitimi i SHKK-ve ri-investohet 100% në Institucion në mënyrë që të përmirësohen shërbimet dhe ulen Interesat e produkteve të kredisë.
- SHKK-të i shërbejnë vetëm anëtarëve të tyre, kapitali mbetet brenda komunitetit.
- Zotërohet nga anëtarë pronarë – çdo person i cili depoziton para, ndan gjithashtu pronësinë e Institucionit.
- Është Institucion demokratik ku anëtarët-pronarë zgjedhin vetë organet e tyre drejtuese përkatësisht Këshillin Drejtues dhe Komitetin e Kontrollit.
- Është i orientuar drejt shërbimit, për SHKK-në, anëtarët janë të parët.

MISIONI, VIZIONI & VLERAT

MISIONI YNË

Misioni i UniFin është t'i ofrojë shërbime të plota financiare anëtarëve të saj, me profesionalizëm dhe përkushtim ndaj çdo anëtari, duke funksionuar si institucion jo fitimprures me parim udhëheqës bashkëpunimin dhe ndihmëen reciproke.

VIZIONI YNË

Vizioni ynë është ai i të qënit një pikë referënce për të gjithë qytetarët dhe bizneset të cilët e shohin anëtarësinë pranë UniFin jo vetëm si një mënyrë financimi të nevojave ekonomike, por edhe si një angazhim qytetar pranë një Institucioni të përgjegjshëm dhe të përkushtuar ndaj përmbushjes së rolit të tij në zhvillimin e vendit.

VLERAT TONA

- ✔ Solidariteti dhe bashkpunimi mes anëtarëve të SHKK-së
- ✔ Vullneti i lirë i anëtarëve për anëtarësimin në SHKK
- ✔ Numri i pakufizuar i anëtarëve për anëtarësimin në SHKK
- ✔ Integriteti
- ✔ Transparenca
- ✔ Përkushtimi

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i UniFin. Ajo thirret nga Këshilli Drejtues jo më pak se një herë në vit dhe vendimet e saj janë të detyrueshme për anëtaret. Shkk Unifin dhe degët e saj kanë në strukturën e saj 15, 256 anëtarë të cilët zgjedhin organet drejtuese të SHKK-së. Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme janë:

- Administrimi dhe drejtimi i veprimtarisë së Shkk-së.
- Zgjedhja e Këshillit Drejtues.
- Miratimi e ndryshimi i Statutit dhe rregulloreve të Shkk-së.
- Miratimi i rezultateve financiare vjetore dhe projekt buxhetit.
- Miratimi i raporteve të drejtimit të Shkk-së.
- Marrja e vendimeve për të gjitha çështjet e tjera të rëndësishme.

Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues i UniFin zgjidhet me votim të fshehtë nga Asambleja e Përgjithshme e Shkk-së, nga radhët e anëtarëve të UniFin dhe degëve të saj. Ai është organ egzekutiv i Shkk-së dhe përbëhet prej jo më pak se 7 anëtarë, për një periudhë të përcaktuar në aktet e brendshme rregullative. Këshilli Drejtues zgjedh kryetarin e tij dhe zëvendës kryetarin.

Komiteti i Kontrollit

Komiteti i Kontrollit i UniFin është organ i mbikqyrjes dhe kontrollit të veprimtarise financiare dhe administrative. Objekti i tij, është të mbikëqyrë të gjitha veprimet financiare të kryera, të sigurohet që keshilli drejtues të marrë vendime sipas statutit dhe sipas vendimeve të Asamblesë së Pergjithshme.

Anëtarët e Këshillit Drejtues

1. Jolanda Trebicka – Kryetare
2. Arben Qafezezi – Nën Kryetar
3. Mimoza Hamza – Sekretare
4. Engjell Jazxhi – Anëtar
5. Ruzhdi Koni – Anëtar
6. Vladimir Caci – Anëtar
7. Suela Coka – Anëtar
8. Vojsava Rama – Anëtar
9. Sabri Skenderi – Anëtar

Anëtarët e Komitetit të Kontrollit

1. Merita Çela – Kryetare
2. Mimoza Breçani – Anëtare
3. Suela Coka – Anëtare



PRODUKTET & SHËRBIMET

KREDI

KREDIA KONSUMATORE

Monedha: Lek & Euro & Dollarë
Shuma: Sipas nevojës.
Afati: deri në 5 vjet.
Këste të barabarta kthimi.
Interesat më konkurruese në treg.

KREDIA AGRO

Monedha: Lek & Euro & Dollarë
Shuma: Sipas nevojës.
Afati: deri në 5 vjet.
Kolaterali: Në varësi të shumës, kërkohet Garantor ose Hipotekë.
Këste shlyerje mujore.

KREDI BIZNESI

Monedha: Lek & Euro & Dollarë
Shuma: Sipas nevojës.
Afati: deri në 5 vjet.
Kolaterali: Në varësi të shumës, kërkohet Garantor ose Hipotekë.
Këste shlyerje mujore.

DEPOZITA

DEPOZITA

Maturimi: 12, 24, 36, 48, 60 muaj e më shumë.
Norma më konkuruese e interesit në treg,
deri në 5,5% sipas shumës së depozituar.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Në UniFin ne kujdesemi që produktet tona të jenë të aksesueshme nga të gjithë sepse ne besojmë në bashkpunimin mes anëtarëve dhe stafit tone e sëbashku nuk reshtim së kërkuari opsionet më të favorshme e gjithpërfshirëse. Një sërë masash lehtësuese për anëtarë tanë i bëjnë produktet tona më fleksibël se çdo Institucion tjetër, anëtarët kanë mundësi ta zgjedhin vetë datën dhe shumën e pagesës që mund të bëjnë në varësi të kredisë së kërkuar, interesat e kredive e aq më shumë të depozitave janë ndër më konkurueset në treg, si dhe ka gjithnjë tolerime të vogla të kësteve të shlyera në varësi të kushteve të gjithsecilit.

Ne kujdesemi që përpos shtresave në nevojë, të jemi një pikë referimi njësoj si për burrat ashtu edhe gratë. Prandaj me krenari çdo vit pasqyrojmë një raport pothuajse të barabartë e që anon më shumë ndaj anëtareve gra kredimarrëse.

TREGUESIT FINANCIARË

KAPITALI
219,572,771

TOTAL ASETE
1,057,499,606

PORTOFOLI I DEPOZITAVE
796,001,093

PORTOFOLI I KREDISË BRUTO
764,360,837

UNIFIN

NR. I KREDIVE TË DISBURSUARA
1,876

SHUMA E KREDIVE TË DISBURSUARA
570,209,648

PORTOFOLI NË RISK (NPL)
5.4%

KREDIA MESATARE
262, 545

SHPËRNDARJA E PORTOFOLIT

Shpërndarja e Portofolit sipas Produkteve



Shpërndarja e Portofolit sipas Gjinisë



Shpërndarja e Riskut sipas Produkteve



Kursim kredi qe prej 1996

Kapërcimi me sukses i sfidave gjatë vitit 2017 e ka forcuar Institucionin duke shenjuar një hap më tutje drejt angazhimit kundrejt anëtarëve të tij në dhënien e shërbimeve më të mira e më të sigurta. Një nga sfidat më të rëndësishme të këtij viti ka qenë marrja e çertifikatës nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave e cila është një garanci më shumë dhe një arritje si për Institucionin ashtu edhe anëtarët e tij. Kështu që prej vitit 2017, për herë të parë, depozitat e çdo anëtari janë të siguruara deri në shumën 2,000,000 lekë.

AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVT

LICENCA E BANKËS SË SHQIPËRISË

Përfundimi i proçesit të konsolidimit të të gjitha shkk-ve në një të vetme, i cili filloi në vitin 2015 dhe përfundoi me shndërrimin e Unionit Jehona dhe shkk-së së saj të vetme NewCred në shkk-në UniFin, ka qenë gjithashtu ndër sfidat më të rëndësishme e që u realizua me sukses në vitin 2017. Sukses që u finalizua me marrjen e Licensës nga Banka e Shqipërisë.

U N I F I N

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË

Nr. 1/1

Tiranë më 14.07.2017

LICENCË

Nr. 1, datë 27.06.2002

PËR TË VEPRUAR SI SHOQËRI KURSIM-KREDITI NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.05.2016 "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre", të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre", miratuar me vendimin nr. 104, datë 5.10.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të vendimit "Për miratimin e shndërrimit të Unionit të shoqërive të kursim-kreditit "JEHONA" në shoqërinë e kursim-kreditit "UNIFIN", nr. 6605/5 prot., datë 14.04.2017 të Drejtorit të Departamentit të Mbikëqyrjes, shoqërisë "UNIFIN" i jepet licenca për të vepruar si shoqëri kursim-krediti në Republikën e Shqipërisë.

Licenca i lejon shoqërisë së kursim-kreditit "UNIFIN" të kryejë veprimtaritë e përshkruara në aneksin bashkëlidhur.

Licenca është e pakufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e patjetërsueshme.

DENIZ DERALLA

DREJTOR

NJË IMAZH I RI I INSTITUCIONIT

Gjatë vitit 2017, sëbashku me ndryshimin ligjore dhe Institucionale, u investua edhe në Infrastrukturë si dhe në uniformizimin e imazhit nëpër të gjitha degët UniFin.

Në këtë mënyrë është krijuar një ambjent komod për anëtarët si dhe siguri në zhvillimin e vazhdueshëm të një Institucioni i cili nuk resht së qëni në shërbim të të gjithë njerëzve dhe nevojave të tyre.

NJË IMAZH I RI I INSTITUCIONIT

Imazhi i ri UniFin ka për qëllim përcjellen e një mesazhi të ngrohtë dhe dashamirës e në të njëjtën kohë të sigurt dhe transparent. Investimet në infrastrukturën e brëndshme të zyrave mundësojnë një punë dinjitoze dhe brenda standardeve të punonjësve UniFIn, qëllimi i të cilëve është shërbimi sa më i mirë ndaj anëtarëve.

AMBICIET E INSTITUCIONIT 2018

- ✔ Ofrimi i produkteve kundrejt respektit, transparencës në komunikim, kofidencialitetit, mos diskriminimit dhe evitimit të mbingarkesës me borxhe.

- ✔ Fokusi në financimin e Bizneseve dhe sipërmarrjeve Agro të vogla dhe të mesme, duke luftuar kësisoj kushtet e vështira ekonomike si dhe duke krijuar vende të reja pune e duke dhënë kështu një kontribut thelbësor në ekonominë e vëndit.

- ✔ Rritja e Institucionit me antarë dhe degë të reja për të mbështetur sa me shume njerëz në nevojë.

- ✔ Zgjerimi i produkteve të ofruara në mënyrë që të plotësohen kërkesat e domosdoshme.

- ✔ Rritja e fokusit Social të institucionit në drejtim të luftës ndaj varfërise dhe rolit të Gruas.

PASQYRAT FINANCIARE - BILANCI

2017

Aktivet	
Mjete Monetare	133,419,824
Depozita me Afat në Banka	147,757,541
Bono Thesari	39,317,464
Hua për Anëtarët (neto)	713,682,946
Aktivet afatgjata jo-materiale	1,490,394
Aktivet afatgjata të tjera materiale	14,092,642
Kërkesa të arkëtueshme	7,738,795
Totali i Aktivëve	**1,057,499,606**
Detyrimet	
Depozitat nga Anëtarët	814,704,366
Fonde Rezervë	12,462,049
Detyrime të Tjera	10,760,420
Total Detyrime	**837,926,835**
Kapitali	
Kontributet e Anëtarëve	18,435,052
Fondet e Donatorëve	66,803,819
Rezervat Ligjore, Statutore & Të Tjera	34,760,984
Fitim / Humbja e grumbulluar	89,281,206
Fitimi / Humbja gjatë vitit	10,291,710
Totali I kapitalit	**219,572,771**
Totali i Detyrimeve dhe Kapitali	**1,057,499,606**

TË ARDHURA / SHPENZIME

2017

Të ardhura nga Interesat	40,854,134
Shpenzime nga Interesat	(10,945,502)
TëArdhurat neto nga Interesat	29,908,632
Shpenzime për fondet rezervë	(5,641,227)
Të Ardhura neto pas zhvlerësimit të huave	(5,641,227)
Të ardhura nga shlyerjet e huave të fshira	2,039,016
Të ardhura të tjera të veprimatarisë	235,559
Shpenzime të tjera të veprimtarisë	(216,257)
Të Ardhura të tjera neto	2,058,317
Shpenzime Personeli	(15,615,054)
Shpenzime Administrative	(9,727,519)
Shpenzime për organet drejtuese	(3,196,488)
Shpenzime zhvlerësimi & amortizimi	(1,001,142)
Totali i Shpenzimeve administrative	(29,540,203)
Rivlerësimi valutor	156,793
Fitimi / (Humbja) gjatë vitit	(3,057,688)

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Drejtimin e Unifin Shoqëri Kursim Krediti,

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Unifin Shoqëri Kursim Krediti (më poshtë "Shoqëria" ose "Unifin SHKK") që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për periudhën e mbyllur në këtë datë, si edhe një përmbledhje të politikave kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Unifin SHKK paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017, performancën e saj financiare dhe flukset e mjeteve monetare për periudhën e mbyllur dhe ndryshimet në kapital në atë datë, në përputhje me ligjin shqiptar "Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim kreditit dhe të unioneve të tyre".

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Entiteti në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit Ndërkombëtar për Standardet e Etikës (Kodi i IESBA) dhe Kodit të Instituit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (Kodi i IEKA), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" të amenduar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Njohja e të ardhurave nga interesi mbi baza te arkëtimit

Ne tërheqim vëmendje ne lidhje me njohjen e të ardhurave nga interesi i kredive. Sic shprehet edhe në shënimin 3(k) të pasqyrave financiare, të ardhurat nga interesi i kredisë njihen atëherë kur arkëtohen dhe jo në bazë rritëse atëherë kur përfitohen. Në bazë të rregullores së Bankës së Shqipërisë "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim kreditit dhe të unioneve të tyre" SHHK-të ekistuese përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, duhet të marrin masa që interesin nga kreditë ta kontabilizojnë mbi baza rritëse brenda datës 30 Qershor 2021.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen Për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me ligjin shqiptar "Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim kreditit dhe të unioneve të tyre", dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, per shënimet shpjeguese për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale perveç sa më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e proçesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë proçedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.

- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për proçesin e auditimit

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.

- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijëmësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë vazhduar në vijëmësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së entitetit

- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar me qeverisjen objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Date 20.06.2018



TPA Albania Shpk

Laura Gjinali EKR Nr. Lic 351

RRJETI I DEGËVE UNIFIN

Tiranë
Adresa: Rr: "Kajo Karafili",
Pallati 10, Ap. 3
Tel: +355 4 23 30 120
Cel: +355 69 20 80 064
e-mail: ocane@unionijehona.org

Durrës
Adresa: Lagjia nr. 11,
Rruga: "Aleksandër Goga",
Pallati "Gora", Kati i II.
Cel: +355 68 24 09 696
e-mail: hdervishi@unionijehona.org

Vlorë
Adresa: Lagjia "Lef Sallata",
Bulevardi Ismail Qemali,
Kompleksi Konad, kati 2
Cel: 069 20 80 069
e-mail: esotirovski@unionijehona.org

Korçë
Adresa: Bulevardi Shen Gjergji,
Qendra Baze, Kati 3, Korçë
Cel: +355 69 20 80 068
e-mail: dceta@unionijehona.org

Pogradec
Adresa: Rruga "Lulezim Sulollari",
Ndertesa 19
HYrja 9, Apartamenti 0
Cel: 069 20 99 663
e-mail: abeka@unionijehona.org

Kozare
Adresa: Lagja Qender, Rruga
"Dikater", Kozare
Cel: +355 (0)69 28 38 550
e-mail: mkoxhai@unionijehona.org

Divjakë
Adresa: Lagjia Nr. 2,
Rr. Demokracia,
Godine dy kateshe me
nr pasurie 490/112, Kati II
Cel: +355 69 20 68 853
e-mail: njanku@unionijehona.org

Fier
Adresa: Lagja "Kastriot",
Rruga "Rapi Toska",
Hyrja 1, Godina 62
Cel: +355 68 22 704 75
e-mail: agrembi@unionijehona.org

Berat
Adresa: Rruga"Antipatrea", krah
Gjykatës së Rrethit, Berat
Cel: +355 69 47 36 448
e-mail: vpelivani@unionijehona.org

Patos - Fier
Adresa: Lagjia 1 Maji,
Bulevardi Republika,
Godina Nr. 4
Cel: +355 69 76 44 406
e-mail: lmeco@unionijehona.org

Goriçan - Berat
Adresa: Lagjia Qender,
Rruga Clirim,
Fshati Gorican – Kutalli
Cel: +355 69 29 51 537
e-mail: lgoga@unionijehona.org

Laç
Adresa: lagj.nr.3. Rruga"Erjon
Hoxha" Pallati 43 ,kati 1
Cel: +355 (0)68 20 13 154
e-mail: kgjaci@unionijehona.org

Cërrik
Adresa: Njesia administrative
Gostime, Fshati Shtermen,
Rruga nacionale Cerrik – Gramsh,
Ndertesa Nr. 006
Cel: +355 68 54 60 872
e-mail: alamcja@unionijehona.org

Gramsh - Lushnje
Adresa: Fshati Gramsh,
Rruga e Caneve,
Ndertesa Nr. 178, Hyrja 1
Cel: +355 69 27 85 124
e-mail: melezi@unionijehona.org

Metaj - Libofshë - Fier
Adresa: Fshati Libofshe,
Zona kadastrale 2448,
Blv. Naun Prifti, Nr. 15/2,
Cel: +355 68 22 704 75
e-mail: sngjela@unionijehona.org

Roskovec
Adresa: Rruga Nacionale,
(Përballë Bashkisë)
Roskovec,
Cel: +355 69 69 93 453
e-mail: dhoxha@unionijehona.org

Orikum
Adresa: Rruga "Princesha Rugjine",
Lagjia 4 Dhjetori, Nr 1
Cel: +355 69 92 96 956
e-mail: axhaka@unionijehona.org

Elbasan
Adresa: Lagja "Clirimi", Rruga "Sule
Misri", Ndertesa nr 2, Hyrja 4
Cel: +355 69 440 0757
e-mail: hhalili@unionijehona.org

ANËTARËT TANË



NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

www.unifin.al

/unifin

Shkk_UniFin

shkk_unifin

Zyra Qëndrore:
Rr. “Dervish Hima”, Pall.8, Hyrja 5 | Tiranë | Tel: +355 4 2224 469

KURSIM·KREDI QË PREJ 1996